

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, ora 10:29 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari I Bashkisë Elbasan Z. Asim Sula anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e radhës së Këshillit të muajit Mars 27.03.2026 Ftoj sekretarin të bëj apelin

Elsid Zyma-Sekretari I Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin prezent janë 51 antarë.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, ora 10:29 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari I Bashkisë Elbasan Z. Asim Sula anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 2 e rendit të ditës

2. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Shkurt 2026.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, 0 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A.(D.Madhi)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, ora 10:29 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari I Bashkisë Elbasan Z. Asim Sula anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 2.1 e rendit të ditës


2.1. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Shkurt 2026.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, 0 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A.(D.Madhi)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, ora 10:29 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari I Bashkisë Elbasan Z. Asim Sula anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” sh.a.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Ka qënë një muaj me shumë aktivitete, kemi pasur ditën e verës kemi pasur shumë aktivitete dhe doja tju uroja të gjithëve Gëzuar Ditën e Verës. Për të gjithë komunitetin tonë musliman ka qënë një muaj I shenjtë dhe I uroj shumë që sakrific të jetë e pranuar dhe Bajrami të ketë ardhur I mbarë.

Jemi në një perjudhë që po vjen vera por sot në Gjinar na ka rënë dhe dëborë ka qënë një atmosferë shumë e mirë. Para se të filloj të shpjegoj pikën tre do të doja mirëkuptimin tuaj që të heci me disa pika paralelisht. Në pikën tre në lidhje me asetet e Bashkisë Elbasan për transferimin në drejtorin rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Sh.a. ashtu sic e dini dhe ju KUZ tashmë është një Sh.a rajonale me aksionere dhe nga ministria kryesore e infrastrukturës me përqindjen më të madhe por cdo bashki ka përqindjet e veta. Asetët ashtu sic një pjesë e tyre janë transferuar në fillim kur kjo ishte ndërmarrje shtetërore dhe një pjesë bashkë me investimet që janë bërë gjatë viteve kur ka qënë në administrim dhe të Bashkisë Elbasan një pjesë e tyre të cilat ishin bërë dhe nuk ishin maturuar tek pjesa e garancisë dhe ,bylles së investimit nuk u transferuan në atë kohë pasi kanë ngelur dor për dorë për tu kaluar një nga kto janë dhe disa investime të kryera nga bashkia Elbasanit për kanalizimet e ujërave të zeza në disa zona të qytetit të Elbasanit sipas vlerave përkatëse të inventarit për këtë është kërkuar që të kalohet në këtë fazë është mbyllur dhe pjesa kontraktuale ndërko në të ardhmen ka përsëri asete të cilat kalojnë sidomas kanalizimet e ujërave të zeza ku është një system në cilin ujësjetllës kanalizimet, drejtoria rajonale e KUZ I taton I tarifon qytetarët e Elbasan pra për kto lagje ajo ja u merr tarifën e

mirëmbajtjes së kanalizimeve të ujrave të zeza dhe në rast se kjo ka një difekt apo një problematik atë duhet ta bëjmë ne me ndërmarrjen tonë të punëve publike për sa kohë kjo tarifohet edhe duhet të mirëmbahet nga ndërmarrja e ujësjellës kanalizimeve, do të ketë dhe në vazhdimësi ka dhe disa zona të tjera të cilat janë bërë investime për kanalizimet e ujrave të zeza të cilat janë prioriteti jonë kryesor pra 6 vitesh pjesa më e madhe e zonave informale pa kanalizime të ujrave të zeza ka qenë në projektet tona kryesore mbyllja e të gjithë problematikave në qytet me systemin e kanalizimeve të ujrave të zeza. kemi projekte të tjera në bashkëpunim me ujësjellësin duam që brënda 2027 ne ti mbyllim të gjithë problemet në qytet të paktën në zonat informale me kanaliza [zime e ujërave të zeza dhe pastaj të vazhdojmë me pjesën e infrastrukturës rrugore. Është një [roces I cili për shumë zona do të vazhdojë të jëtë në vazhdimësi në KUZ ashtu sic kemi dhe disa ujësjellsa të cilët menaxhohen nga fshatrat dhe ato do të kalojnë ne procesin e KUZ-së dhe kërkojnë disa procedura ng ana jonë. Dua të flas pak dhe për pikën 4, transferimit e fondeve janë transferime normale të grandit të performancës të cilat kalojnë për investime ,Bashkia e Elbasanit ka performuar shumë mirë vitin që kaloi si financiarisht ashu dhe administrativisht kemi qënë një nga bashkitë e mëdhaja me performancën më të mirë në Shqipëri dhe me këtë patjetër me systemin e ri të futur të bonisit të performancës I cili është një bonus financiar është një formë grandit e dhënë nga qeveria shqiptare dhe nga donator të huaj kryesisht Zvicerian dhe Suedes kanë kaluar në buxhetin e Bashkisë Elbasan kto grande të cilat kanë ardhur të pakushtëzuara ne I kemi menduar që ti fusim tek investimet dhe të vazhdojmë me pjesën e investimeve të cilat një pjesë e tyre ka qënë e programuar dhenjë pjesë tjetër të cilat ishin të paspecificuara kto do të kalojnë tashmë me buxhetin e bashkisë Elbasan dhe një pjesë e këtyre ngrandeve të ardhura nga puna e mirë që ka bërë Bashkia Elbasanit dhe nga performanca e mirë të kalojë drejt për drejtë në investime për infrastrukturë për qytetin e Elbasanit. Kemi pikën 5 kontrata e shërbimit për pranimin e depozitimit të mbetjeve urabane të ngurta është një procedurë rutinë e cila kalon cdo vit ashtu sic e kemi theksuar dhe më parë mbetjet urbane në Elbasan menaxhohen një pjesë nga kompania private në qytet dhe pjesa tjetër nga ndërmarrja jonë e punëve publike zonat rurale, bëhet vetëm tërheqaj ndërkohë që përpunimi I tyre bëhet në impjantin e trajtimit të mbetjeve ne Elbasan I cili në fakt ka një status asset I sekuestruar I cili është marrë me qera dhe menaxhohet nga ndërmarrja jonë e punëve publike ECO-ELB e cila është aksionere në shtatë bashkitë e qarkut të Elbasanit ktu në këtë prizëm ka pasur një zhvillim me ligjin e ri I cili u miratua vitin që kaloi dhe me të gjithë

kiadrin ligjor tashmë ky asset ose të gjitha fushat e mbetjeve do të administrohen nga një kompani qendrore shtetërore e cila nga agjencia e trajtimit të mbetjeve është kthyer në një shoqëri aksionere, jemi në traktativa për kalimin pasi një pjesë e tyre janë asete të sekuestruara dhe automatikisht kalojnë nga agjencia e aseteve të sekuestruara drejt për drejt tek ndërrmarrja e re e cila është krijuar me kapital totalisht shtetëror dhe një pjesë tjetër e aseteve të cilat I kemi krijuar ne gjatë këtyre viteve me ndërrmarjen tonë të Eco-Elbit do të filloj një process transferimi dhe I atyre, ajo për të cilën po negociojmë tani dhe do të kërkoja nëse arrijmë në konkluzione, negociata positive, do të kërkoja dhe një mbledhje jashtë radhe në mes të muajit prill për një informacion më të detajuar për këtë proces I cili po ndiqet sipas procedurave ligjore. Ndërko ndërrmarja Eco-Elb janë dy varjante në të cilat po diskutohet bashkë me agjencinë ose me shoqërin e cila do të merret me administrimin e mbetjeve në formën e përthithjes pra që e gjitha ndërrmarja Eco-Elb të përthithet apo në formën e marrjes së aseteve dhe ndërrmarrja Eco-Elb që ne ekemi të vazhdoj të merret jo më me menaxhinin e imjantit të trajtimit të mbetjeve por gjër të tjera të cilat shatë bashkitë mund ta vendosin. Pikërisht për këtë duam tju informojmë në mes të muajit prill nëse do të kemi rezultate konkrete. Kjo është një kontaktë specifike e cila dhe për muajity të cilët kanë kaluar për Janarin, Shkurtin, marsin dhe der isa të mbyllet procesi I përthithjes së ndërrmarjes së Eco-Elbit dhe I menaxhimit të mjantit të trajtimit të mbetjeve nga agjencia shtetërore gjithashtu ka përfunduar paraprakisht dhe një projekt të cilin ne e kemi parë në bashkëpunim dhe me Akemin për trajtimin e fushës së mbetjeve I cili Akoma nuk është përfundimtar por fo ti japi një zgjidhje trajtimit të mbetjeve në qytetin e Elbasanit dhe në të Shata bashkitë bashkë me Rrogozhinën të fushës së mbetjeve. Dua të ndaj me ju një lajm shumë pozitiv I cili është në pikën 7 ku kontata klimatike, Elbasani ashu sic ne e kemi shpjeguar disa herë në Këshill bashkiak por edhe publikisht është bërë pjesë e 100 qyteteve të Bashkimit European për Zerocity dhe smartcity është një nga misionet e Bashkimit European ku është kuptuar që ndryshimi klimatik nuk vjen vetëm nga qeveria por vjen nga pushteti vendor nga Bashkitë. Këtë qasje kemi pasur dhe ne prej shumë vitesh ku jemi bërë pjesë e këtij misioni mbas një pune të gjatë gati 3 vitesh dhe një strukture të posacme në Bashkinë e Elbasanit por dhe me ndihmën e këshilltarëve të cilët I kemi ne Bruksel të vënë në dispozicion nga Bashkimi european kemi arritur të mbylлим me shumë sukses kontratën klimatike e cila është miratuar nga Bashkimi european dhe nga Netzero në datë 16 shkurt kjo është një procedurë me të cilët njihet Këshilli bashkiak por dhe miratohen të gjithë hapat të cilët ndiqen për të pasur

qëllimin tonë të përbashkët për tu afruar me bashkimin europian dhe për të pasur një qasje sa më positive ndaj mjedisit, tashmë e kemi thënë është një luftë e përbashkët e jona mjedisi është kryesori dhe heqja e Elbasanit nga harta e një qyteti të ndotur kjo do të ndodhi shumë shpejt në bazë dhe të punës tonë të përbashkët. kjo është një kontratë janë shumë gurë kilometrik të cilët ndiqen hap pas hapi deri isha të arrijmë në qëllimin tonë të përbashkët për të ulur ndotjen. Në pikën 6 kemi miratuar në fund të vitit një formë shpërblimi për arritjet të cilat do të arrinte futbollit ekipi I futbollit të Elbasanit bashkia e Elbasanit është aksionere ne kemi miratuar një buxhet në të cilin ne I vendosim targedat tonë në formë shpërblimi dhe të shpërblehen për ekipin e futbollit të Elbasanit, deri tani ka ecur mirë me një performancë të mirë një pjesë e tyre pritet të kalojë pasi është buxheti I vitit 2026 dhe është miratuar që në vitin 2025 një pjesë të atyre arritjeve ata tashmë I kanë arritur të targetave që ne I kemi vënë të pikave që duhet të arrijnë në kompjonat dhe në kupë por është dhe një mënyrë për ti vendosur para përgjisisë ,motivimi ekipin e futbollit dhe pjesën sportive. pasi është një vlersim financiar kundërshtëpërblim sot ne miratomë formën dhe procedurën e cila ndiqet për shpërndarjen e këtij grandi. gjithashtu në pikën 9 ne do të fillojmë shumë shpejt dhe në mbledhjen tjetër do të sjellim dhe nismën që ne do të ndërrmarim për të hapur një ndërrmarrje shtetërore bashkiake e cila do ti vi në ndihmë të gjithë fermerëve dhe do të merret kryesisht me ktivitete bujqësore deri tani ne kemi marrë me punet rurale publike por është parë shumë e domosdoshme që të jetë një institucion bashkiak e cili të merret me dhe në ndihmë të fermerëve. Probleme në bujqësi patjetër që ka, probleme në bujqësi nuk zgjidhen vetëm me kanalet vetëm me rrugët rurale por dhe me ngritjen e vlerës së produktit të cilët fermerët prodhojnë, ne gjatë ditës së verës kishin nxjerrë dhe 2 Njësi administrative Shirgjan dhe Gjinar ku bashkuan fermerët e tyre me një qëllim të përbashkët që të rrisin vlerën fundore të produktit të tyre bujqësor, kjo është një gjë e mirë një eksperiencë e cila në fakt ne kemi kohë që e punojmë kemi pasur esperienatë mira dhe I kemi ardhur në ndihmë dhe fermerëve të cilët janë bashkuar në koperetiva të ndryshme sic është ajo e vit të ullirit por dhe bashkimi I fermerëve gra në zonën e Shirgjanit kemi 2 procese të cilat paralelisht po I djekim rivitalizimi I një parcele toke që ne e kemi në fushën e aviacionit në Gjergjan ose në fshatin Thanë është një tokë shtetërore e cila në fakt nuk është ndarë me 7501 por nuk është transferuar as në Bashkinë e Elbasanit kjo është në pikën 9 aty planifikohet që të bëjmë pika të mëdha grumbullimi ku bashkia të jetë pjesë në bashkëpunim dhe me fermerët privat në mënyrë që të kemi një system më të mirë të mbledhjes të përpunimit por dhe të nxjerrjes së pruduktit fundor në tregun e

Elbasanit por jo vetëm atë Shqiptar pse jo dhe ndërkombëtar.Ky është qëllimi jemi duke ecur me projekte paralelisht me projekte të bankës botërore kemi disa kohë dhe tashmë kemi arritur në fazën finale që ne duhet të mbyllim procedurat e tokës dhe të lejes dhe pastaj një pjesë dhe të investimit.kemi dhe qëllimin që të ngrejmë dhe një pikë,të bëjmë pjesën e ambalazhimit të produkteve dhe për këtë do të shërbejnë ndërrmarja e cila do ta prezantojmë në mbledhjen e ardhshme,e cila do të jetë një ndërrmarrje shtetërore bashkiake në menaxhim të Bashkisë Elbasan por e lirë që të ndërhyjë në veprimtari ekonomike SHBB në ndërrmarrje të përbashkëta me fermerët e Bashkisë Elbasan.Faleminderit.

Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Transferimi I aseteve nga Bashkia Elbasanit, Shoqëris Rajonale të Ujësjetës, në tabelë na është dhënë një shumë prej 68.8 milion lekësh të reja është ndërtim rrjeti në zonat informale, është rrjet I ndërtuar dhe është për mirëmbajtje apo do të ndërtohet një rrjet.

Asim Sula-Nënkryetar I Bashkëse Elbasan

Bëhet fjalë për një investim për një rrjet të ndërtuar që është bërë dhe I kalon si aset KUZ-së,kto asete I kalojnë KUZ-së për mirëmbajtje nëse nuk kalojnë kto si asete kush do ti mirembajë është pyetja?Eshtë një praktikë e domosdoshme.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, 0 kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(B.Copja,A.Kana,Z.Muzhaqi,A.Shtylla,A.Marku)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, ora 10:29 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari I Bashkisë Elbasan Z. Asim Sula anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 4 e rendit të ditës

4. Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028, si dhe përdorimi i grantit për performancë.

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo u diskutua dhe ne mbledhjen e kaluar janë dy projekte që Bashkia Elbasan aplikoi tek Fondi I Zhvillimit Shqiptar për dy rrugë ndërtimi I rrugës se re tek rotondo e varrezave dhe rivitalizimi urban I unazës jugore me kryqëzimin e çerrikut por nuk dominuan fitues ishte projektuar 10 % e vlerës dhe 90 nga fondi shqiptar I zhvillimit atëherë mbi bazën e nevojave të domosdoshme që ka komunitet bashkia ka vendosur që kt projekt ta realizojë me buxhetin e saj dhe ta ndajë ne tre vite në vitin e parë 20% 2026 dhe në buxhetin afatmesëm 2026-2028 të japi diferencën dhe është bërë përllogaritja përkatëse dhe kërkohet një fond shtesë prej 15 milion 785 e 678 është dhe një projekt për systemin e kamrava të koshave ku është bërë një shtesë fondi prej 45 milion lekësh dhe është mednuar që burumi dhe finacimi do të jenë tepricat e prokurimeve të disa objekteve dhe disa teprica fondesh të palikujduara, do të jetë dhe grand I performancës që ka përfituar Bashkia me 6 milion 292 e 134 pra të gjitha kto teprica dhe ky grand mbulojne 20 % e projektit të dy rrugëve dhe të kamrave. Besoj se nuk ka ndonjë diskutim është një investim I domosdoshem për komunitetin dhe duhet të miratohet.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë nuk dua të jem përsëritëse sepse sic e tha zoti Shefqet ky është një projekt vendim I diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar dhe për sa I përket investimit që do të bëhet në rrotondon e varrevaze dhe në intersektimin e rrugës Nos Josifi me lagjen Emin Matraxhiu e kam bërë parashtrimin tim dhe kjo lidhje më tepër me zgjidhjen e konfliktëve të pronësis me banorët që janë aty në zonë dhe me koston që do të kishte bashkia për të dëmshpërmyer më vonë këtë shpronësim por ajo që më bie akoma në sy lidhet me faktin që jua bëm edhe herën e kaluar këtë lloj vërejtje vazhdoni fusni dhe ngatëroni futen kamerat prap tek projektvendimi që ka lidhje me investimin pse nuk I ndani kto dy projekt vendime un nuk jam dakord për kamrat jam dakord për investimin përshëmbull ose anasjelltas cfarë problem real keni që nuk I ndani kto projekt vendime pse duhet të kalojnë kto të gjitha bashk.Kamrat nuk janë ndonjë investim I madh se nuk ka nevoj njeri të marri ato koshat me plera,rruga po është investim dhe është zhvillim me kmra me ndricime me lule,bëjmë rrugën kamerat brënda.

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ky është shkelja për ndarje sepse dhe buxhti I shtetit kur miratohet miratohen investimet në total si Republikë dhe ne kur miratojmë buxhetin e bashkisë miratojmë të gjithë projektet dhe nuk është detyrim ligjor që për cdo ku është shkelja ligjore ktu që janë dy projektvendime duhen të jenë 2 apo 1

Alketa Merkja-Përfaqësuese E Bashkisë Elbasan

Ne aty kemi mbledhur të gjitha tepricat e kontratave teprica që kanë dalë nga fondet kemi dhe grandin e performancës janë mbledhur të gjitha kto teprica ne nuk mund ti bëjmë dor të ndara kto janë të bashkuara bashkë dhe pastaj ndahen në tre objekte të ndryshme I bie që po I njëjti vendim të përsëritet,të përsëritet I njëjti relacion sepse burimet e financimit aty janë të ndryshme.Kto nuk janë investime të reja.

Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Jemi shumë dakord me zhvillimin sidomos me zhvillimin që po merr pjesa e rrugës së varrezave sepse atje do ishte gjë shumë e mirë që ta mbyllim atë gjë. Ne sapo kalim buxhetin dhe kaluam 200 milion lekë për kamerat ju vini dhe kërkoni 45 milion lekë të tjera për kamerat. Ku do ti çoni gjithë këto kamera? Tek tabela e zhvillimeve për të dyja zhvillimet që duam të bëjmë ndërtimi i rrugës tek rotondo varrezave dhe rivitalizimi midis shesheve të pjesës jugore të unazës ndarja në tre vite e ndërtimit të rrugës tek rotonda më duket pak e sikletshme kjo. M'ashpjegoni do ndërtohet rruga pa u financuar dhe do të financohet gjatë tre viteve nëse është kështu ok, 26 milion lekë për dy vitet e ardhshme dhe 31 milion me 31 milion lekë për dy vitet e ardhshme atëherë kalonim në investimin më të rëndësishëm që është ajo e rotundos dhe pastaj kalojmë tek investimet që kemi të bëjmë. Do ta bëjmë rrugën brenda një viti dhe këto lekë do merren për tre vjet.

Asim Sula-Nënkryetar I Bashkisë Elbasan

Të sqarojmë dikë të rëndësishme ligjërisht çështja është ok, parimisht Dorisi ka të drejtë dhe mund të ndahet kjo gjë. Ajo që doja të shpjegoja është që janë investime të domosdoshme, për sa i përket sistemit të kamrave ka lindur kjo domosdoshmëri për kushtet reale dhe vështirësitë që ne hasim sepse mbetjet urbane shpesh nuk hidhen në kosh duhet të survojohen dhe të vendosen gjëra për sjellje të tilla, bëhen djegjet e koshave pra survejimi është i domosdoshëm për të realizuar sa më mirë procesin e pastrimit dhe survejimit të koshave. Ti konsiderojmë të domosdoshme si pjesë e rëndësishme e procesit. Për sa i përket investimit është menduar që të ndahet në lote pra 20% e fondit të parë do të bëhet këtë vit, është mirë që të përfshin si investime dhe ta fillojmë që këtë vit.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë jam dakord që të këto investime dhe financim për investime në qytet sepse janë të domosdoshme sidomos në hapjen e rrugëve të reja dhe kur ato vijnë nga një pjesë e komunitetit nga konsultimi publik pra nga mënyra se si e keni konceptuar buxhetimin e këtij projekti 200 m rrugë e shtrirë në tre vite unë nuk e kuptoj. Ju keni vetëm pjesën e pagesës por unë nuk besoj se ka ndonjë investitor që investon me paratë e veta të gjithë rrugën deri në fund për një vit për 6 muaj për atë sa mund të bëhet 200 m rrugë kjo mënyrë e të operuarit të bashkisë Elbasan është e dukshme investimet janë të frura vetëm në parashikime kurse në realizim janë

shumë të ulëta, kjo është një nga arsyet pse ju shkatërrohen kaq shpejt rrugët, sepse nuk mund të investohet në një rrugë sot e hapim e lëme aty një vit të mbushet me ujë të degradohet dhe mbas një viti të kujtohem të hedhim cakullin mbas një viti të shtrojmë asflatin dhe kështu I gjithë investimi I shtrirë në kaq shumë kohë në tre vjet sepse unë nuk e besoj që investituro me lekët e veta do të na bëj vepra publike nuk ka investitor privat që e bën nëse e bën dikush do të thotë që ka thyer rregullat e ekonomisë së tregut. Pse nuk përfundon automotoparku kur ka investitor të tillë që marrin përsipër një vepër kaq madhështore për qytetin që do të na sjelli kaq të ardhura do na sjelli dhe formula 1 dhe nuk e investon me paratë e tij dhe të presim pastaj pagesën nga qeveria dhe bashkia. Hiqni dorë nga kjo llojë mënyre e të bërit të investimeve thjesht fryni zëra që të kënaqni njerëzit të thuash ti në Elbasan ka shpërthyer punë e madhe por realizim reduktohem në ndërtimin e një rruge në një vit. Faleminderit.

Dritan Ceka-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Për objektin në fjalë financimet të një rrugë për tre vite apo dy vite bëhen në momentin kur paralelisht kohëzgjatja grafiku I punimeve bëhet paralelisht me financimin në rastin konkret duhet të ishte tre vjet kohëzgjatja e punimeve dhe financii të bëheshe për tre vjet ai objekt me ato parametra teknik që ka në eksperiencën time si inxhinier nuk do më tepër sesa nga 8-12 muaj dhe unë ju garantoj që nëse ndiqni këtë llogjikë financimi do kemi mal; e me zhavor, gropa me ujë që do të rrinë pafundësisht deri në fund të tre viteve. unë ju sugjeroj që më mirë hiqni një objekt tjetër dhe mbaroni një objekt duke cilësuar cili është më urgjent për komunitetin dhe për qytetin sesa të ndiqni këtë rrugë e cila është e dështuar.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 10 kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(E.Jaurri,B.Copja)

V.K(V.Balliu,D.Cepa,A.Domni,M.Kaculi,A.Kana,D.Madhi,A.Marku,A.Mecja,Z.M
uzhaqi,A.Shtylla)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.03.2026, ora 10:29 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetari I Bashkisë Elbasan Z. Asim Sula anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 5 e rendit të ditës

5. Mbi miratimin e kontratës së “Shërbimit publik për pranimin, depozitimin, trajnimin e mbetjeve urbane të ngurta të Bashkisë Elbasan”, në imjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të ngurta të Qarkut Elbasan midis Bashkisë Elbasan dhe “ECO-ELB sh.a”.

Bianka Copja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqënëse saga e kontratës së Eco-Elbit vazhdon dua të ndalem në një çështje thelbësore me heqjen e incenerimit nga objekti kontratës defakto e keni pranuar që ky incenerator nuk funksionon dhe pavarsisht kësaj qytetarët vazhdojnë të paguajnë shumë më tepër në këto kushte kam një pyetje.

Për sa i përket procesit të trajtimit I cili është pjesë e objektit të kontratës a kryhet realisht kështu process?

Leli Kaja-Përfaqësues I Eco-Elbit Elbasan

Procesi I trajtimit kryhet normalisht kurse procesi I djegjes kur kemi bërë vjet mbledhjen që kemi miratuar cimin me 26 vetëm për trajnim për pranim sipas procedurave ligjore nuk bëhet procesi I djegjes pasi ka gati një perjudhe 2 vjet e gjys ,basi ne e mbajtem në punë inceneratorin për 7 muaj ndezur që këtë e kemi thënë dhe herë të tjera aktualisht dhe tani është në fazë remondi kanë ardhur disa grupe të huajshësh të cilët po merrem me menaxhimin dhe me situatën për ta vënë në punë inceneratorin njëkohësisht po bëhet dhe një projekt për të ndërtuar një landfill të ri ngjitur me landfillin ekzistues mund të vini dhe ti shikoni ose mund të na sillni letër me shkrim dhe ne ju kemi kthyer përgjigje kurse për rastin konkret bëhet pranimi me 26 mijë lekë dhe pa marrsh fitimi dhe vjet ka qënë për tu bërë 50 mijë lekë me

djegie por ka kaluar vetem faza e parë e pranimit jo me djegie sepse nuk punon inceneratori aktualisht. Që ka pasur probleme inceneratori ne e kemi thënë.

Bianka Copja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Më thatë që funksionon trajtimi sepse në shkresën zyrtare që më keni sjellë e pohoni që trajtimi nuk ndodh, tani më jep një përgjigje përfundimtare me shkresë zyrtare e kam që trajtimi nuk ndodh ndërkohë tani po më thoni që po në shkresën tuaj zyrtare besoj se e dini shumë mirë ca keni sjellë incenerimin e keni hequr që kur ka qënë në kontaktë e keni pohuar me shkresë që incenerimi nuk ndodh e heqim incenerimin dhe kur ka qënë paguar për incenerimin. Për trajtimin përsëri keni pohuar që nuk ndodh, e keni në shkresë të shkruajtur që nuk ndodh. Dua thjesht një përgjigje të saktë ndodh apo jo trajtimi në inceneratorin e Elbasanit.

Leli Kaja-Përfaqësues I Eco-Elbit Elbasan

